Kronikë

Tiranë/ Lëvizte me pistoletë me vete, arrestohet 38-vjeçari, anëtar i bandës së Gjergj Cukalit! E pësON edhe pasagjeri (EMRAT+VIDEO)

Një 38-vjeçar i cili lëvizte me makinë me armë me vete është arrestuar nga blutë e kryeqytetit në rrugën "Ali Demi". Në pranga ka rënë edhe pasagjeri i automjetit, për moskallëzim krimi.

Redaksia
14 Qershor, 10:18 | **Përditesimi: 14 Qershor, 11:42**

Share

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Tiranë- Një 38-vjeçar i cili lëvizte me makinë me armë me vete është arrestuar nga blutë e kryeqytetit në rrugën "Ali Demi". Në pranga ka rënë edhe pasagjeri i automjetit, për moskallëzim krimi.

Të arrestuarit janë identifikuar si Krisald Kundraxhi dhe Jurgen Kovaçi.

Mësohet se 38-vjeçari Kundraxhi, anëtar i bandës së Gjergj Cukalit, i njohur si i forti i 'Myslym Shyrit. Kundraxhi është arrestuar edhe me paré për të njëjtat vepra penale. Në vitin 2016, ai u vendos në pranga nga policia e Tiranës bashkë me Cukalin.

LEXO EDHE:
Britanikët u kapën duke shitur drogë në Dhërmi, gazeta 'Mirror': Rrezikojnë 15 vite burg

Gjatë kontrolleve të kryera policia përveç armës së zjarrit gjeti dhe sekuestroi municion luftarak, një sasi prej 304 gram lëndë narkotike kokainë, rreth 131 tableta ekstazi, 3 peshore elektronike dhe automjetin.

Njoftimi i policisë:

Shërbimet e Komisariatit të Policisë Nr. 1, në vijim të kontrolleve për kapjen e shtetasve në kërkim, të atyre që qarkullojnë me armë apo lëndë narkotike, mbi bazën e informacioneve të siguruara nga inteligjenca policore, kanë organizuar dhe finalizuar operacionin policor të koduar "Check Point".

Gjatë operacionit, në rrugën "Ali Demi" shërbimet e Policisë kanë ndaluar automjetin me drejtues shtetasin K. K dhe pasagjer shtetasin J. K.

Gjatë kontrollit fizik dhe më tej të banesës së shtetasit K. K. iu gjetën 1 armë zjarri pistoletë, municion luftarak, një sasi prej 304 gram lëndë narkotike kokainë, rreth 131 tableta ekstazi, 3 peshore elektronike si dhe pjesë arme.

Në përfundim të veprimeve procedurale u arrestuan në flagrancë shtetasit:

K. K., 38 vjeç, banues në Tiranë, për veprat penale "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve, armëve shpërthyese dhe municionit" dhe "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve";

J. K., 34 vjeç, banues në Tiranë, për veprën penale "Moskallëzimi i krimit'.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë së Tiranës, për veprime të mëtejshme.

Xh.K/Shqiptarja.com

TAG: gjergj cukali | drogë | arme zjarri | Tirane | Jurgen Kovaçi | Krisald Kundraxhi

Komento

Komente

Leksi: 15/06/2025 13:19

Jepini nai lek se i kan lon te gjitha ne poker

Përgjigju

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Kë mbështesni në konfliktin mes Izraelit dhe Iranit?

14 Qershor, 10:56

Izraelin | Iranin | Asnjërën palë

Lajme të tjera

Tiranë/ Rrëzohet teksa po lëvizte me biçikletë, 60-vjeçari ndërron jetë në spital
15 Qershor, 13:26

Nesër samiti i SEECP në Tiranë, policia njofton planin e masave: Ja rrugët që do të bllokohen
15 Qershor, 13:06

Tiranë/ Autor i 3 vjedhjeve në kryeqytet, arrestohet 44-vjeçari! I sekuestrohen 8 aparate celular, municion luftarak, sende me vlerë, mjete identifikimi dhe 1 armë e ftohtë
15 Qershor, 11:36

Të hënën samiti i SEECP në Tiranë, Begaj do të presë krerët e shteteve të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (AXHENDA)
15 Qershor, 10:48

Tiranë/Bëri manovra të rrezikshme me automjet, vendoset në pranga 39-vjeçari që përplasi 5 këmbësorë! Braktisi makinën dhe u largua (EMRI+VIDEO)
14 Qershor, 13:12

Ishin në kërkim për mashtrim e shpërdorim detyre, 5 të arrestuar në Tiranë (EMRAT)
14 Qershor, 12:53

Abuzoi me fondet dhe punësoi familjarët e tij, në pranga ish-kreu i Urdhrit të Stomatologut! Gjykata: Mund të prishë provat, rrezik largimi
14 Qershor, 11:59

Vengu inspekton laboratorin e ri ushtarak në Spitalin e Traumës: Përfitojnë rreth 75 mijë pacientë! Buxhetet e mbrojtjes janë në rritje çdo vit
14 Qershor, 10:59

'Gerardio Bosio, është i pari dhe i vetmi dhe më i madhi i ndërtimeve të viteve 1935-1940 në Shqipëri', historitë e panjohura të italianëve që projektuan Tiranën moderne

Zyliftar Hoxha

14 Qershor, 08:11

Jakin Marena: PD shpalli 'tradhtarë' numëruesit e vet, 'firmosë' numërimin elektronik

Jakin Marena

13 Qershor, 19:05

Pamjet/ Disa aksidente të njëpasnjëshme në Tiranë! Simulime te sheshi "Nënë Tereza" për ndërgjegjësim

Joana Preja

13 Qershor, 17:41

Sulmet e Izraelit ndaj Iranit/ Anulohen fluturimet Tiranë-Tel Aviv dhe anasjelltas, në ato të planifikuara sot nuk kishte asnjë shqiptar
13 Qershor, 16:23

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje